

PROCESVERBAL

Nga seanca e urgjente (e jashtëzakonshme) e Këshillit të Komunës së Brvenicës, e mbajtur më 23.01.2026, (e hënë) duke filluar nga ora 14.00 në ambientet e Komunës së Brvenicës

Të pranishëm: 12 këshilltarë.

Mungonin: Nikolçe Nedelkoski, Mumin Redzepe dhe Jovica Radeski

Seancën e hapi dhe e drejtoi Kryetari i Këshillit, Robert Miloseski, i cili arriti në përfundimin se nga numri i këshilltarëve të pranishëm kishte kuorum për vendimmarrje të plotë dhe tha se kur është në interes të qytetarëve, ata janë gjithmonë këtu për çështje të tilla urgjente dhe të pashmangshme.

Për seancën u propozua rendi i ditës vijim.

Rend I ditës

1., Propozim - Plani Komunal i Energjisë për vitin 2026 për Komunën e Brvenicës.

Kryetari i Këshillit tha, ju e kishit rendin e ditës dhe e lexuat, të njëjtin e vendosi në votim dhe u miratua nga këshilltarët e pranishëm.

I

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, "Plani Komunal i Energjisë për vitin 2026 për Komunën e Brvenicës",

Kryetari i Këshillit ia dha fjalën Personit Përgjegjës nga komuna për të shpjeguar në lidhje me pikën.

Personi Përgjegjës nga komuna mori fjalën dhe tha se deri më 26 janar duhet të paraqesim një akt të miratuar nga Ministria e Energjisë në mënyrë që ata ta paraqesin atë.

Efikienca e energjisë është një sërë masash të planifikuara dhe të zbatuara për të konsumuar më pak energji në mënyrë që të përfundojmë të njëjtën punë. Komuna jonë i ka kushtuar vëmendje të veçantë efikasitetit të energjisë në ditët e sotme dhe ka përgatitur plan sipas Ligjit të Energjisë nga Ministria. Ne dërguam të njëjtin plan dhe morëm miratimin në këmbim. Qëllimi ynë është të zvogëlojmë konsumin e energjisë dhe sigurisht kostot e Buxhetit. Synimet tona specifike janë të zvogëlojmë konsumin në objektet komunale dhe ta zvogëlojmë atë me 30% deri në vitin 2027. Në fushën e ndriçimit rrugor, kemi 90 km instalime, 2400 llamba, nga të cilat 1860 janë zëvendësuar me LED për të zvogëluar konsumin. Burimet financiare janë përcaktuar nga Buxheti për të arritur këto qëllime dhe ne planifikojmë të aplikojmë për projekte të tjera. Në vetë programin, keni një lidhje me kompanitë që duan të prodhojnë energji elektrike dhe këto kompani duhet të jenë në plan në mënyrë që të mund të lidhen. Për të kursyer energji elektrike, të gjitha shkollat ngrohen me peleta nëse Buxheti na lejon, nëse kemi sukses, duam të instalojmë edhe

pompa nxehtësie. Shkollat kanë instaluar fasada të reja me izolim të mirë dhe ky është një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e nxehtësisë në klasa.

Kryetari i Këshillit hapi diskutim.

Samir Ganiji u paraqit dhe tha, a janë këto kompani të lidhura apo u duhet miratim dhe një kërkesë për të njëjtën gjë?

Personi Përgjegjës nga komuna foli gjithashtu dhe tha, për të ndërtuar panele fotovoltaike, së pari duhet miratim, dhe ata e marrin nga ne në komunë. Për momentin, këto kompani kanë paraqitur një kërkesë, por ndërkohë, nëse dikush tjetër paraqet një kërkesë, ajo do të përfshihet shtesë në këtë plan në mënyrë që të mund të lidhet. Ne, si komunë, do ta informojmë ministrinë se edhe ai subjekt dëshiron të lidhet.

Robert Miloseski u paraqit dhe tha, pra të gjithë po e ndjekin biznesin e tyre përmes EVN-së dhe po lidhen, më parë ishte ndryshe.

Personi Përgjegjës nga komuna u paraqit përsëri dhe tha, gjatë vitit 2026, ata mund të ndërtojnë panele të tilla në tokat që ne kemi shitur në Stençe sepse ata tashmë kanë miratim. Nëse dikush kërkon të lidhet ndërkohë, kjo mund të përfshihet në program. Gjatë vitit, ne mund të bëjmë ndryshime dhe shtesa në plan dy herë.

Edhe Idriz Idrizi mori fjalën dhe tha, a duhet t'i përfshijmë të gjitha ndryshimet apo...

Samir Ganiji mori përsëri fjalën dhe tha, a duhet që çdo subjekt që paraqet një kërkesë të shkojë në këshill, në mënyrë që të mos rezultojë që ne i japim dikujt të ndërtojë dhe dikujt jo...

Personi përkatës nga komuna iu drejtua përsëri diskutimit dhe tha, po bëjmë një listë të subjekteve që kanë paraqitur një iniciativë dhe po ia dërgojmë atë listë Ministrisë së Energjisë.

Meqenëse askush tjetër nuk u paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit e vuri në votim pikën, Plani Komunal i Energjisë për vitin 2026 për Komunën e Bërvenicës, dhe ajo u pranua nga këshilltarët e pranishëm.

Pas shterimit të pikave të rendit të ditës, seanca e jashtëzakonshme (urgjente) e Këshillit të Komunës së Bërvenicës përfundoi.

Procesverbalist,
Hristina Radiçeska
Përktheu,
Ferdane Idrizi

Nr.08-75/2
Bërvenicë

Kryetar,
Robert Millosheski

